

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPECË** Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, sipas gjyqtarit Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit N.N. nga fshati ....., komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 285 par.1 të KPK-së sipas propozim akuzës PP.nr.1505-06/12 të dt.25.09.2012 dhe vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP.nr.2239-03/2012 e dt.11.02.2013 të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me dt.20.05.2016, në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Visar Musa dhe të pandehurit N.N., të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **N.N.** nga fshati ....., komuna e Ferizajt, data e lindjes....., në të njëjtin vend, nga i ati **R.** dhe e ëma **M.**, e gjinisë **Rr.**, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, babë i gjashtë fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike.

**ËSHTË FAJTORË**

**SEPSE:**

**I.** Me datë 11 korrik 2012 rreth orës 14:00, në rajonin ekonomik-pyJOR të fshatit Kashtanjevë, komuna e Shtërpçës, në vendin e quajtur “kodra e madhe, paralelja 63” me qëllim vjedhje ka prerë me sharë motorike 5 copë dru ahU me diametër 25-48 cm, me gjatësi prej 19 m në vëllim prej 2,62 m<sup>3</sup>, në vlerë prej 353,70€.

- me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 285 par.1 të KPK-së.

**II.** Me datë 12.11.2012 rreth orës 13:30 në pyllin publik të cilin e menagjon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Shtërpçë, në rajonin ekonomik-pyJOR në fshatin Kashtanjevë, në vendin quajtur “paralelja 66”, me qëllim vjedhje, me sharë motorike ka prerë 8 copë dru ahU, me gjatësi prej 19 m, me diametër 40-50 cm, në vëllim prej 10,94 m<sup>3</sup> dhe në vlerë prej 358 par.2 të KPRK-së.

- me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve të sipërtheksuara si dhe neneve 6, 11, 34, 36,38, 64, dhe 71 të KPK-së dhe dispozitave të neneve 4,7,41,42,43,45, 46, 48, 73 dhe 80 të KPRK-së dhe neni 365 të KPRK-së të pandehurit i

**VËRTETON**

Për veprën penale në pikën **I** dënim me burgim në kohzgjatje prej **1** muaji.

Për veprën penale në pikën **II** dënim me gjobë në shumën prej 200 € si dhe dënim me burg në kohzgjatje prej **3** muajve.

Konform nenit 71 të KPK-së dhe nenit 80 të KPRK-së të pandehurit i

### **SHQIPTON:**

**DENIM UNIK ME GJOBË NË SHUMËN PREJ 200 € SI DHE DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 3 (tre) MUAJVE.**

Gjykata konform nenit 46 par.5 dhe 48 par.1 të KPRK-së pas komunikimit të dënimit unik, me pëlqimin e personit të dënuar dënimin me gjobë dhe me burgim i'a zëvendëson me urdhrin për punë në dobi të përgjithëshme.

Gjykata urdhëron të pandehurin të kryej punë në dobi të përgjithëshme pa pagesë për një periudhë të caktuar kohore prej 240 (dyqindë e katërdhjetë) orë pune.

Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithëshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithëshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithëshme duhet të kryhet dhe e mbikqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithëshme.

Puna në dobi të përgjithëshme nga ana e të dënuarit duhet të kryhet brenda gjashtë muajve nga dita e plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi.

Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithëshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithëshme, gjykata do të ekzekutoj dënimin unik me gjobë dhe me burg.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasurore-juridike të dëmtuarës DZHE-zyra në Shtërpçës në emër të dëmit të shkaktuar t'ia paguaj shumën e përgjithëshme prej 1830,60 këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që kësaj gjykate në emër të shpenzimeve gjyqësore, gjegjësishtë paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej 20 €, këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me propozim akuzën PP.nr.1505-06/12 të dt.25.09.2012 dhe aktakuzën PP.nr.2239-03/2012 ka akuzuar të pandehurin N.N. nga fshati ....., komuna e Ferizajt, përshkak të veprave penale vjedhje e pyllit nga neni 285 par.1 të KPK-së, dhe vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas këtyre akuzave me dt.24.09.2014 mbajti shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Visar Musa dhe i pandehuri N.N..

Në shqyrtimin fillestar gjykata duke vepruar konform nenit 35 par.7 dhe 8 të KPPRK-së me pëlqimin e prokurorit të shtetit, sipas detyrës zyrtare bëri bashkimin e procedurave penale për lëndet penale të evidentuara pranë kësaj gjykate kundër të pandehurit dhe atë për propozim akuzën PP.nr.1505-06/2012 të dt.25.09.2012 dhe aktakuzën PP.nr.2239-03/2012 të dt.11.02.2013 dhe për të njëjtat ka zbatuar procedurë të bashkuar pasi që në rastin konkret në të dy akuzat është akuzuar personi i njëjti si dhe janë kryer vepra të njëjta penale.

Në vazhdim gjyqtari ka konstatuar se i pandehuri në afatin ligjor ka pranuar propozim akuzën respektivisht aktakuzën me të cilat është akuzuar i pandehuri.

I pandehuri është udhëzuar në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPRK-së se ka të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen ose të mos përgjigjet në pyetje e gjykatës, e nëse deklarohet nuk ka për detyrë të inkriminon vehten apo të afërmit e tij e as të pranon fajësinë, të mbrohet vetë apo përmes ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij si dhe të kundërshton aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave.

Lidhur me këtë i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi të drejtat e tij mbi të cilat është udhëzuar nga gjyqtari, mbrojtës nuk do të angazhon, mbrojtjen do ta bënë vetë dhe do të përgjigjet në pyetjet e gjykatës.

Pas kësaj gjyqtari i kësaj çështje penale ka ftuar prokurorin e shtetit për të lexuar propozim akuzën PP.nr.1505-06/12 të dt.25.09.2012 dhe aktakuzën PP.nr.2239-03/2012.

Pas leximit të propozim akuzës dhe aktakuzës së përmendur nga prokurori i shtetit dhe pasi gjyqtari është bindur se i pandehuri i ka kuptuar në tërësi të drejtat e tij që i takojnë me ligj, se i ka kuptuar edhe akuzat, të njëjtit i ka dhënë mundësinë të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij për veprat penale për të cilat është akuzuar.

Lidhur me këtë i pandehuri N.N. ka deklaruar se e ndjenë vehten fajtor dhe e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar si në propozim akuzë ashtu edhe në aktakuzë të cilat i janë lexuar nga prokurori i shtetit duke theksuar se është e vërtet se me dt.11.07.2012 ka qenë në pyll dhe është takuar me rojtarin i cili edhe i ka bërë fletëparaqitjen .

Gjithashtu edhe me dt.12.11.2012 ka qenë në pyll dhe ka bërë atë për të cilën edhe është akuzuar ashtu siq është përshkruar në aktakuzë.

Në fund të deklaratës së tij ka kërkuar nga gjykata që gjatë matjes së dënimit të ketë parasyshë të gjitha këto fakte dhe rrethana në të cilat janë kryer këto vepra penale gjegjësishtë të më shqiptoj një sanksion penal më të butë pasi është i gjendjes shumë të varfër ekonomike dhe nuk është duke punuar askund si dhe i duhet të kujdeset për anëtarët e familjes së tij gjegjësishtë gjashtë fëmijët e tij.

Pas deklarimit të të pandehurit mbi pranimin e fajësisë, gjyqtari u bind se i pandehuri ka kuptuar në tërësi natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht dhe është bazuar në faktet e çështjes që përmbajnë akuzat dhe në provat e prezantuara nga prokurori i shtetit, këtë edhe për arsyen se porpozim akuzat respektivisht aktakuza nuk përmbajnë ndonjë shkelje ligjore apo gabim teknik, për çka gjyqtari konsideron se pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 të KPPRK-së dhe duke u bazuar në të njëjtin nen par.2 gjyqtari ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit Visar Musa, i cili ka deklaruar se pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi i njëjti është bërë konform ligjit duke i propozuar gjykatës që gjatë matjes së dënimit pranimin e fajësisë nga i pandehuri ta merr si rrethanë lehtësuese.

Gjyqtari i çështjes është bindur se janë vërtetuar të gjitha faktet mbi pranimin e fajësisë, kështu që duke u bazuar në nenin 248 par.4 të KPPRK-së ka sjellë aktvendim procedural mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe procedurën penale e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe nga provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, gjegjësisht nga fletparaqitja nr.81/2012 dhe procesverbali me të njëjtin numër, fletparaqitja nr.150/2012 dhe vlerësimi dhe llogaritja e dëmit të pyllit me të njëjtin numër, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se i pandehuri datë 11 korrik 2012 rreth orës 14:00, në rajonin ekonomik-pyjor të fshatit Kashtanjevë, komuna e Shtërpçës, në vendin e quajtur “kodra e madhe, paralelja 63” me qëllim vjedhje ka prerë me sharë motorike 5 copë dru ahë me diametër 25-48 cm, me gjatësi prej 19 m në vëllim prej 2,62 m<sup>3</sup>, në vlerë prej 353,70€.

Ndërsa me datë 12.11.2012 rreth orës 13:30 në pyllin publik të cilin e menagjon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Shtërpçë, në rajonin ekonomik-pyjor në fshatin Kashtanjevë, në vendin quajtur “paralelja 66”, me qëllim vjedhje, me sharë motorike ka prerë 8 copë dru ahë, me gjatësi prej 19 m, me diametër 40-50 cm, në vëllim prej 10,94 m<sup>3</sup> dhe në vlerë prej 358 par.2 të KPRK-së.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjyqtari gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë ekzistuar të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 285 par.1 të KPK-së dhe veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, për çka të njëjtin e ka shpallë fajtorë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK-së dhe 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tij, sjelljen e tij korrekte në procedurën penale, se i njëjti ka pasë sjellje të mira në të kaluarën, është i martuar dhe ka gjashtë fëmijë, nuk është duke punuar askund dhe ka gjendje të varfër ekonomike. Andaj në bazë të këtyre rrethanave gjykata ka vlerësuar shkallën e

përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprave të cilat i njëjti i ka kryer dhe pas këtij vlerësimi të pandehurit i shqiptoi dënimin unik me gjobë në shumën prej 200 € si dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 muajve e të cilat dënime me përlqimin e të pandehurit, e konform nenit 46 par.5 dhe 48 par.1 të KPRK-së ia ka zëvendësuar në urdhr për punë në dobi të përgjithshme duke e obliguar që të kryej punë pa pagesë për periudhën kohore prej 240 orë punë në dobi të përgjithshme e të cilën punë shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryej punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion me peshën e veprave penale, rrethanave të kryerjes së tyre dhe personalitetin e të pandehurit dhe se me të do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i pandehuri të mos kryej vepra penale dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të këtyre veprave penale në shoqëri, konform nenit 34 të KPK-së dhe 41 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPRK-së ka obliguar të pandehurin që të dëmtuarës DZHE në Shtërpcë ti kompenzoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 1830,60 këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u theksua ma lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË**  
**P.nr.93/2012 dhe P.nr.58/2013 dt.20.05.2016**

**Asistenti**  
Muedin Rexhepi

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa  
në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit,  
Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.